



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 nëntor 2013  
Nr.ref.:RK500/13

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI85/13**

Parashtrues

**N. T. SH. Q. D. “Driloni Commerce” Prishtinë**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të  
Kosovës, Rev. E. nr. 4/2010, të 21 janarit 2013**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është N. T. SH. Q. D. “Driloni Commerce”, një kompani private nga Prishtina, e përfaqësuar nga avokati Sabri Kryeziu nga Lipjani.

## **Objekti i çështjes**

2. Objekt i çështjes së kërkesës së dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. E. nr. 4/2010, të 21 janarit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 15 shkurt 2013.

## **Baza juridike**

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 47 të Ligjit dhe rregullin 56 të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

4. Më 13 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
5. Më 20 qershor 2013, Kryetari e caktoi gjyqtarin Robert Carolan si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
6. Më 23 korrik 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin lidhur me regjistrimin e kërkesës në Gjykatë.
7. Më 23 korrik 2013, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme në lidhje me kërkesën.
8. Më 18 tetor 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

## **Faktet e rastit**

9. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë kundër dy kompanive private për kompensimin e dëmit në shumë prej 616, 478 eurosh.
10. Më 8 qershor 2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin nr. II. C nr. 422/2008 dhe e refuzoi padinë e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e saj, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë theksoi, *ndër të tjera*, se *“gjykata nuk miratoi propozimin e paditësit [pra, parashtruesit] për nxjerrjen e provës që të bëhet super ekspertizë, për shkak se parashtruesi nuk i kishte prezantuar faturat e kërkuara nga ana e ekspertit financiar.”*
11. Më 3 nëntor 2009, parashtruesi paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të lartcekur, duke pretenduar ndër të tjera, se kërkesa e tij për të bërë një super ekspertizë *“ishte refuzuar pa ofruar asnjë arsyetim ...”*.
12. Më 18 maj 2010, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin nr. Ae. Nr. 200/2009 dhe e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës së 3 nëntorit 2009 si të pabazuar. Në arsyetim, Gjykata Supreme theksoi se *“në faqen 3, pasusi i fundit të ekspertizës financiare me shkrim, rrjedh se eksperti më 28 janar 2009 ka*

*kontaktuar me përfaqësuesin ligjor të paditësit, në të cilin takim përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se nuk posedon dokumentacion tjetër pos atij që gjendet në shkresat e lëndës. I njëjti nuk e ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga eksperti ..., e as që ka paraqitur vërejtje në dokumentacionin e pranuar nga i padituri i parë”.*

13. Më 17 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të 18 majit 2010. Parashtruesi ripërsëriti se kërkesa e tij për të bërë një super ekspertizë, e dorëzuar në Gjykatën e Qarkut, ishte refuzuar në mënyrë të paligjshme.
14. Më 21 janar 2013, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. E. Nr. 4/2010, me të cilin e refuzoi kërkesën e parashtruesit për revizion kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të 18 majit 2010, si të pabazuar. Gjykata Supreme vërtetoi se *“nuk qëndrojnë thëniet e revizionit ... sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i goditur është i qartë, arsyetimi përmban arsye për faktet vendimtare, kurse dispozitivi i tij nuk është në kundërshtim me arsyetimin dhe se gjykata e shkallës së dytë në arsyetimin e saj ka dhënë përgjigje të mjaftueshme ... të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.”*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

15. Parashtruesi pretendon se i është shkelur e drejta për barazi para ligjit, e garantuar me nenin 3 të Kushtetutës, pasi që kërkesa e tij për një ekspertizë shtesë ishte refuzuar.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

16. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregullore të punës.
17. Gjykata vëren se në esencë, parashtruesi ankohet se i është cenuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa).
18. Neni 31.1 i Kushtetutës thekson:

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.*
19. Gjykata rithekson se parimi i barazisë së armëve është pjesë e një koncepti më të gjerë të gjykimit të drejtë, në kuptim të nenit 6 paragrafi 1 të Konventës. Ky parim kërkon një “ekuilibër të drejtë” ndërmjet palëve: secilës palë duhet t'i ofrohet mundësia e arsyeshme për ta paraqitur rastin e tij/saj, me kushte që nuk e vënë atë në situatë të pafavorshme përballë kundërshtarit ose kundërshtarëve të tij/saj (*Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin Gorraiz*

*Lizarraga dhe të tjerët kundër Spanjës, nr. 62543/00, paragrafi 56, GJEDNJ 2004-III).*

20. Gjykata gjen se në rastin konkret nuk është shkelur parimi i barazisë së armëve. Gjykatat e rregullta e shqyrtuan në detaje pretendimin e parashtruesit dhe nxorën konkludime konkrete se parashtruesi asnjëherë nuk kishte paraqitur ndonjë provë që do ta arsyetonte sjelljen e dëshmisë së një eksperti tjetër. Prandaj, nuk ka prova që e mbështesin pretendimin e parashtruesit.
21. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1; shih gjithashtu Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI70/11, të parashtruesve Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr. 983/08, të 7 shkurtit 2011).*
22. Si përfundim, parashtruesi as nuk e ka ndërtuar rastin mbi shkeljen e ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë dhe as që ka ofruar ndonjë provë *prima facie* për atë shkelje (*Shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, GJEDNJ, Vendimi sa i përket pranueshmërisë së kërkesës, Nr. 53363/99, i 31 majit 2005).*
23. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës që parasheh se "*Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar*".

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113(7) të Kushtetutës dhe rregullit 36 të Rregullores së punës, njëzëri

### VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Robert Carolan



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani